



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 3811 Prot.

Ballsh, më 27.07.2022

VENDIM

Nr. 41 Datë 26.07.2022

PËR

**AKORDIMIN E TITULLIT “QYTETAR NDERI”, I BASHKISË MALLAKASTËR
AZBI RAMADAN SERANAJ**

Në zbatim të pikës m, neni 54 i ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të nenit 15 të ligjit nr. 112/2013, “Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Mallakastër nr. 12, datë 24.02.2020, “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit të Bashkisë Mallakastër”, si dhe të shkresës nr. 4 prot., datë 10.03.2022 “Propozim për dhënie tituj nderi”, të Shoqatës “Familjet e Dëshmorëve të Aviacionit”, administruar pranë Bashkisë Mallakastër me nr. 1350 prot., datë 10.03.2022, relacionit datë 19.07.2022 të Komsionit këshillimor për dhënien e titujve të nderit, ngritur me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Mallakastër nr. 537, datë 11.12.2020,

VENDOSI:

1. Dhënien e titullit “Qytetar Nderi”, Azbi Ramadan Seranaj, pas vdekjes, me motivacion: “Për kontributin e çmuar si pilot i talentuar mallakastriot si dhe profesionalizmin e spikatur në përgatitjet luftarake, i cili dha jetën në krye të detyrës për mbrojtjen e hapësirës ajrore të Atdheut”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Sportit, Turizmit dhe Shëndetësisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi në bazë të pikës 6, të nenit 55, të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETAR

Fitim Baraj

